

## NË EMER TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal**, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, sekretaren juridike Sanije Troshupa, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit A. A. nga P., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ë, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4439/2015, dt.04.08.2016, dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë **02/03/2017**, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4439/2015, dt.04.08.2016, kjo Gjykatë i jep këtë;

## URDHËR NDËSHKIMOR

### I pandehuri:

**A. A.**, nga i ati **B.**, i lindur me datën *data e lindjes...*, në fshatin **Z.**,tani me vendbanim në P., rruga "...", p.nr., me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

**SEPSE:** Me datë 30/07/2015, rreth orës 07:50 minuta, në magjistralen Besi – Milloshevë, përkatësisht në fshatin Prugoc, Komuna Prishtinë, i pandehuri **A. A.**, për derisa ishte duke e drejtuar automjetin e tipit “Mercedes”, me targa të regjistrimit *numri i targave....*, ngjyrë hiri, ka shkel ligjin mbi trafikun rrugor, ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe të pasurisë, në atë mënyrë që nga pakujdesia ka vepruar në kundërshtim me nenin 42.1 të LSKRR, ashtu që pa u bindur më parë se mund të bëjë një veprim të tillë duke mos rrezikuar apo penguar pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion apo pasurinë, ndërmer veprimin për kthim gjysmë rrethor në rrugë, për çka në pjesën e pasme me pjesën e përparme goditet nga automjeti i tipit “Mercedes”, me targa të regjistrimit *numri i targave....*, të cilën e drejtonte tani i dëmtuari **B. S.**, në shiritin përkatës të lëvizjes, me ç ‘rast, si pasojë shkaktohen dëme materiale në automjete ndërkaq, i dëmtuari sipas ekspertizës mjeko ligjore pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndet.

- **Më këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.**

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 42, 43, 46,73 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 dhe nenit 495 të KPPRK-së, të pandehurit i :

## SHQIPTON

**DËNIM MË GJOBË në shumë prej 200.00 € (dyqindë euro), të cilin dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.**

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, deri në zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg shumën prej 20 (njëzetë) €.

I pandehuri obligohet që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumen prej 40.88€, për ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 20.00€, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar B. S. nga P., Lagja M. ., rruga "...", për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civilo – juridik.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.4439/2015, dt.04.08.2016, po ashtu me të njëjtën datë është parashtruar edhe kërkesa për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, kundër të pandehurit A. A., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar në bazë të nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e të pandehurit se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas Aktakuzës së Prokurorit të Shtetit.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohet nga provat si vijojnë dhe atë: nga raporti i aksidentit me numër të rastit 2015-AR-1795, dt.30/07/2015, raportet mjekësore në emër të dëmtuarit D. S., ekspertiza mjeko-ligjore e ekspertit mjeko-ligjor Dr.M. G., e datës 19/06/2016, ku lëndimet janë kualifikuar dëmtime të natyrës së lehtë trupore, mendim dhe konstatim i ekspertit të komunikacionit rrugor ing. A. K. e datës 08/12/2015, që konstaton lëshimet e të pandehurit, si dhe prova tjera nga shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë veprimet në kuptim të veprës penale me të cilën akuzohet i pandehuri.

Sipas KPRK-së, për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, dënimi për këtë vepër penale është se kryerësi dënohet me dënim me gjobë apo burgim deri në një (1) vit.

Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-se, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoj rrethanat në matjen e dënimit, duke vlerësuar se një dënim i tillë është adekuat dhe është i përballueshëm në raport me gjendjen e tij ekonomike dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 të KPRK-ës

dhe se i pandehuri do të përmbahet dhe do të ketë sidomos kujdes të shtuar në trafikun publik, në mënyrë që të mos rrezikohet jeta, shëndeti dhe pasuria materiale e personave në trafikun publik.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori konform nenit 450 të KPP-ës.

Në mbështetje të nenit 463 të KPP-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin civilo - juridik.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.3509/2016 dt.02/03/2017**

**Sekretarja juridike**  
**Sanije Troshupa**

**Gjyqtari**  
**Rrustem Begolli**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi pala ka të drejtë kundërshtimi, në afat prej 8(tetë) ditësh, nga dita e pranimit, kundërshtimi i parashtrohet kësaj gjykate.